



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština – Assembly*

---

**Legjislatura IV**  
**Sesioni pranveror**

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike  
Mbledhja nr. 21  
Prishtinë, më 28 gusht 2012, në orën 10:00 salla N-225  
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës

**PROCESVERBAL**  
**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR MBIKËQYRJEN E FINANCAVE PUBLIKE**

**Në mbledhje morën pjesë:** Ali Sadriu, Ramiz Lladrovci, Mursel Haljilji, Valbona Dibra, Armend Zemaj, Bali Muharremaj, Afrim Hoti, Adem Grabovci, dhe Albert Kinolli.

**Të ftuar:** Gani Gërguri –BQK.

**Stafi mbështetës i Komisionit:** Fatime Qorri – Koordinatore; Mehmet Simnica - Zyrtar i fushës për ekonomi; Artan Venhari, Albert Krasniqi – KIPRED.

**Mbledhjen e kryesoi:** Ali Sadriu - kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

**Rend dite:**

- 1. Miratimi i rendit të ditës,**
- 2. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Bankës Qendrore të Kosovës dhe pasqyrat e audituara financiare, për vitin 2011.**
- 3. Të Ndryshme.**

*Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.*

**1. Miratimi i rendit të ditës**

*Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, njëzëri miratoi rendin e ditës pa ndryshime.*

**2. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Bankës Qendrore të Kosovës dhe pasqyrat e audituara financiare, për vitin 2011**

**Kryetari** – Komisioni për Buxhet është Komision funksional për shqyrtimin e raportit të BQK-së, por meqenëse Komisioni për Mbikëqyrje është Komisioni i cili ka aprovuar përzgjedhjen e auditorit për auditimin e pasqyrave vjetore financiare të BQK-së, atëherë edhe ky Komision do

të shqyrtoj Raportin vjetor me pasqyrat e audituara financiare. Auditimin e pasqyrave financiare e ka bërë kompania "Grant Thornton" e cila ka dhënë një vlerësim pozitiv për BQK-në. Banka ka bërë progres nga viti kaluar dhe ka filluar të merr disa nga funksionet e veta, si: ka ruajtur nivelin e qëndrueshmërisë, afrimin e sektorit financiar me botën e jashtme, fillimi i tregut të letrave me vlerë, është themeluar fondi i sigurimit të dispozitave, pastaj është formuar byroja kosovare e sigurimit, ka një normë shumë të lehtë të uljes së interesit etj. Asetet në sektorin bankar janë rritë 8.3. megjithatë Kosovës i duhen avancime të tjera të cilat janë sfide për BQK-në si: avancimi i sistemit të pagesave dhe kyçja në swift kod dhe karton të gjelbër. Presim që BQK të ketë një paralajmërim më të hershem për zhvillimin ekonomik. Pastaj, një paralajmërim më të hershëm për normën mesatare të inflacionit p.sh. në vitin 2011 nga 3.5 ka rritje në 7.3, dhe po të kishim paralajmërim të më hershëm Qeveria do të ndërmerre masa. Paralajmërim më të hershëm për deficitin etj. Kërkoj sqarime rreth verimeve të bankave ilegale, pastaj devidentat janë zvogëluar dukshëm, sa i përket fitimeve nga kursi i këmbimit ka humbje prej 1.139milion euro.

Rekomandime nga auditori nuk ka dhe Komisioni di se me çka duhet krahasuar. Kjo është mangësi nga ana e auditorit. Hap diskutimin.

**Gani Gërguri** –Vitin e kaluar BQK ka pasur një norme të larte të inflacionit, afër 7.3% e që është një rritje nga vitit paraprak, po ashtu sa i përket sektorit të jashtëm bilanci tregtar ende mbetet një sfide për Ekonomin e Kosovare. Përkundër rritjes së eksportit ende kemi deficit të lart buxhetore. Po ashtu remitencat e jashtme kanë pasur rritje, për dallim nga vendet në regjion që kanë pasur rënie, kjo për arsye se emigrantët tanë janë të vendosur në Gjermani dhe Zvicër të cilat ekonomikisht qëndrojnë mire.

*Sa i preket sistemit financiare*, vitin e kaluar është përmbyllur me një portfolio të aseteve 3 miliard e gjysmë, kuptohet sistemi financiar përben sistemin e sigurimeve, sistemin bankar, sistemin mikrofinanciar dhe sistemin jo bankar. Sistemi bankar përben mbi 76.3% të pjesëmarrjes në këtë portfolio, apo shprehur në shifra absolut afër 2.6 miliard euro.

Në sistemin bankar nuk ka ndryshime sa i përket numrit të bankave, vazhdojmë t'i kemi 6 banka ku 2 prej tyre janë me kapital vendor.

Sa i parket ndërmjetësimit financiar me anën e kredisë ka rritje rreth 16.4%. Struktura e kredive mbetet e njëjtë, ku vlera totale e kredive ka arrinë në 1.7 miliarde euro për vitin 2011.

*Depozitat-Kosova* mbetet shembull për regjionin norma është 9%, totali i depozitave 2.1 miliard euro llogaritet të jete për vitin 2011. Normat e interesit janë të larta, por bashkë me trupat e Kuvendit, Qeverisë, BQK-së dhe të gjithë aktorët po punojnë që të përmirësohen kushtet për të cilat bankat marrin për justifikim. Sistemi bankar vazhdon të operoj me profit dhe kjo është për tu përshëndetur. Përkundër faktit se normat e kamatave të kredive për vitin 2011 kanë pasur rënie krahasuar me vitin 2010, me Ligj - Banka jep llogari për depozita të qytetarëve dhe pasi që të bëhet kjo atëherë banka përqendrohet diku tjetër.

Institucionet tjera financiare- ka një rritje të aseteve të Kompanive të Sigurimeve, pastaj është një lloj kontrole për Trustin, institucionet mikrofinanciare të cilat kanë një pjesë të mirë të sektorit financiar. Kosto e provizioneve të shërbimeve të pagesave janë në proces të zbritjes që do të jete në interes se qytetarëve të Kosovës, po ashtu kemi një kontroll mbi TKPK, mbikëqyrja e institucioneve mikrofinanciare.

*Aktivitetet mbikëqyrëse-BQK* si rregullator ka bërë progres në hartimin e legjislacionit primar dhe sekondar. BQK merr pjesë në kolegje të ndryshme mbikëqyrëse dhe në konferenca ndërkombëtare, Ka ekzaminim të vazhdueshëm të bankave si dhe ka aktivitet për fushën e implementimit të standardeve ndërkombëtare.

BQK ofron shërbime për bankat komerciale, po ashtu për publikun përmes ndërrimit të kartëmonedhave, mbikëqyrjen e llogarive për mbarë institucionet qeveritare, llogarinë e mjeteve të privatizimit, etj. Sfidë është kyçja në Swift-është bërë përpjekje e vazhdueshme por çështja të SWIFT dhe të Kartoni i Gjelbër varet nga anëtarësimi i Kosovës në OKB, menaxhimi i regjistrimit të kredive për çdo kredi-dhënës apo kredi-marrës.

Paralajmërimet të hershme-banka publikon vazhdimisht në buletinin mujor statistikor dhe këto të dhëna janë mujore, pro janë edhe disa të dhëna p.sh statistika varemi nga ESK etj.

Qeverisja dhe kontrolli i brendshëm- BQK ka bordin e bankës (ka rol mbikëqyrës), pastaj ka bordin ekzekutiv, ka Komitetin e auditimit (i cili përbëhet nga anëtarët e bordit dhe një anëtarë i jashtëm) këtij komiteti i raporton auditori i brendshëm. Pra ekziston një kontroll i shumëfishtë në BQK.

Pasqyrat financiare janë audituara nga Grant Thornton, dhe është një vlerësim pozitiv, megjithatë BQK udhëhiqet nga bordi mbikëqyrës si dhe nga bordi menaxhues të cilat borde në njëfarë forme janë edhe auditorë të punës së BQK. Po ashtu kemi komitetin e auditimit që këtij komiteti i raporton auditori i brendshëm i BQK-së. Sipas pasqyrave BQK ka menaxhuar rreth 1 miliard euro apo 82% e këtyre parave ka qenë e investuar në para. Ka progres në kuadër të shpenzimeve operative. 92% e buxhetit të planifikuar ka qenë i realizuar krahasuar me vitin 2010 është 10% më pak.

Afër 2% e mjeteve mbahet e pa investuar si mjete për të kryer shërbimet operative për nevoja të bankës, afër 47% e mjeteve të cilat BQK i menaxhon janë të AKP, ndërsa pjesa tjetër janë mjete të Institucioneve Qeveritare.

BQK ka një liste të gjerë të shërbimeve që ofron dhe këtë po e arrin për shkak të angazhimit të stafit prej 170 të punësuarve.

**Ramiz Lladrovci** – Përgëzoi BQK-në për një raport të detajuar dhe profesional, për punën e mirë pavarësisht krizës që ka përfshirë shumë shtete të Evropës dhe regjionit si dhe për prezantimin shumë të detajuar para Komisionit. Inkurajoj BQK-në për të vazhduar me një punë të mirë dhe Komisioni do t'i ofroj përkrahjen e nevojshme.

**Armend Zemaj** – Për situatat e zhvillimit të dobët ekonomik fajtoje është Qeveria, e cila nuk është kujdesur për zhvillimin ekonomik të vendit dhe BQK në këtë rast si kategori kushtetuese ka përparësi, por edhe defekte operacionale. Pastaj BQK duhet të jap rekomandime konkrete se si duhet dalë nga kjo krizë!

*Kamatat e larta më mirë të quajtura "fajde" se sa kamata-* në këtë rast BQK nuk ka bërë diçka konkrete rreth uljes së këtyre kamatave.

Si sukses u përmend rritja e aseteve të Kompanive të Sigurimit. Qytetarët po dëmtohen në mënyrë sistematike nga Kompanitë e Sigurimeve, pastaj qytetarët që jetojnë jashtë kanë probleme të vazhdueshme me kartonët e gjelbër.

BQK është bërë partner i mazhorancës në atë që institucionet mikrofinanciare të ndërrojnë statusin. Tani mbetet për t'u parë se çka ka bërë Qeveria dhe BQK në këtë aspekt!

BQK duhet të jap rekomandime të qarta dhe të ketë rol të qartë në zhvillimin ekonomik të vendit. Pse ky rrezik i humbjes së parave është fjala për fondet dhe depozitat? A operojnë banka ilegale në Kosovë-konkretisht bankat serbe? Cilat janë masat e BQK-së në raste të tilla? *Pastaj çështja e mbrojtjes së konsumatorit-* nuk ka mbrojtje të konsumatorit por zbatje të tij duke filluar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, e cila nuk po kryen punën e saj.

**Adem Grabovci** - Përgëzoi punën e BQK-së e cila nuk mund të shihet shkëputur nga institucionet e tjera të Qeverisë, e cila ka bërë një punë shumë të mirë. Auditori jep një vlerësim shumë inkurajues për punën e BQK-së. Normat e interesit janë të larta. Sa ka mundësi që të ndikohet në uljen normave t'ë interesit, sepse kjo do të ndikonte në investimet në vend dhe hapjen e vendeve të punës e cila pastaj reflekton në përmirësimin e jetës së përgjithshme. *Kartoni i gjelbër-* nga kjo goditët drejtpërdrejtë mërgata kosovare dhe kjo çështje duhet të këtë përparësi t'u zgjidhur.

**Valbona Dibra** – Raporti është i përgatitur në mënyrë shumë profesionale dhe kjo tregon se BQK ka përmblyllur një vit me një stabilitet. Pastaj kjo poashtu kjo flet edhe për një stabilitet të përgjithshëm financiar në Republikën e Kosovës. Është harruar të prezantohet këtu në mbledhje për investimet e huaja direkt – ka pasur progres në këtë drejtim - ka pasur ngritje. Po ashtu rritja e depozitave ka qenë një progres. Shqetësuese është norma e lartë e kredi-dhënies! Edhe vitin e kaluar është ngritur kjo problematikë dhe për këtë do të vazhdojmë të ngrinin zërin, sepse kjo është mesë e domosdoshme. Po ashtu në raport është cekur se kredi-dhënia në

sektorin e bujqësisë është shumë e ulët.

Ka zëra se një bankë turke ka shprehur interesim të hyjë në tregun Kosovare. Cili është roli i BQK-së që të ketë një shtytje për investime në sektorin e bujqësisë. Sepse në sektorin e bujqësisë po investojnë vetëm institucionet, e jo sistemi bankar. Ndërsa kur flasim për qeverinë duhet ta themi se Qeveria aktuale është qeverisja më e mirë krahasuar me qeveritë e tjera.

**Gani Gërguri** – Kamatat nuk do t'i quaja fajde, kjo është kosto e ndërmjetësimit financiar dhe në çdo plan biznesi bëhet kalkulimi i burimit të financimit nga i cili dizajnohet plani i biznesit. BQK është e limituar, sepse nuk kemi valutën tonë dhe po punohet me të gjithë aktorët për të ndikuar në këtë.

*Kartoni i Gjelbër*- është shqetësim profesional dhe me këtë po dëmtohen shumë qytetarët tanë, por këtë paguajnë edhe shtetasit e huaj. BQK ka bërë përpjekje në selinë e këshillit të kartonit të gjelbër në Bruksel, por në momentin e fundit kanë dal pengesa si anëtarësimi në kodin statistikor dhe në listën e OKB –së. Po diskutohet me vendet në regjion që në ndonjërin nga vendet të lëshohet karton i gjelbër edhe për veturat kosovare.

*Çështja e rrezikut të humbjes së parave*- është zvogëluar horizonti i investimeve. Për shkak të krizës mundësitë për investime janë më të reduktuara dhe kjo na imponon që të jemi më të sigurt dhe të kujdesshëm.

*Bankat ilegale*- aty ky BQK merr informacion se ka aktivitet të pa-licencuar financiar, atëherë në bazë të ligjit ekzaminohet. Në rastin konkret kemi dy komuna të komunitetit serb. Janë konfiskuar gjerat sipas ligjit dhe janë depozituar në trezorët e BQK, si dhe janë angazhuar prokurorët dhe çështja është në hetime.

Krahasuar me vitin paraprak ka një rënie të të hyrave, dhe kjo nëse i referohemi tabelave vjen si rezultat i normave që kanë rënë në tregun financiar evropian.

Qëndrueshmëria e bankës është e fort 30 milion kapital.

*Kursi i këmbimit*- ne nuk i ekspozohemi këtij rreziku, sepse operojmë me euro dhe investimet bëhen në euro.

*Institucionet mikrofinanciare*- banka do të zbatoj edhe këtë pjesë të ligjit dhe në shtator do të përgatiten edhe 30 rregullore në kuadër të së cilës është edhe rregullorja për mikrofinancat. BQK jep rekomandime dhe ka bashkëpunim me MF dhe Departamentin e Thesarit, përveç publikimeve që janë për gjithë publikun.

*Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, njëzëri nxori këtë*

## REKOMANDIM

1. Të miratohet Raporti vjetor me pasqyrat e audituara financiare të Bankës Qendrore, për vitin 2011.
2. Arsyetimin e Rekomandimit do ta bëjë deputeti Ali Sadriu, Kryetar i Komisionit.

### 3. Të ndryshme

*Angazhimi i Ekspertëve*

*Kryetari konstatoi se, meqenëse ekspertët e angazhuar nga Komisioni mentor Ramosaj dhe Safet Merovcipër shkak të angazhimeve, nuk i janë përgjigjur ftesës për të punuar me Komisionin, Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike njëzëri nxori këtë*

*Përfundim*

*Në vend të ekspertit Safet Merovci, angazhohet Mustafë Hasani, ndërsa në vend të ekspertit Mentor Ramosaj angazhohet Ali Latifi.*

Mbledhja përfundoi në orën 11:40.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

---

Ali Sadriu